

Njoftim Për Shtyp Datë 21 Korrik 2022



21 July, 2022 by KLGJ in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot, në datën 21.07.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si vijon:

Këshilli vendosi shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.07.2022, si më poshtë:

- dy pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat;
- tre pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan;
- katër pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier;
- një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë;
- një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
- një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës;
- një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë;
- një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë;
- një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër;

- një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë;
- tre pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- një pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës;
- një pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë;
- një pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër;
- një pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Në kuadër të përgjegjësive që ka lidhur me rekrutimin e gjyqtarëve të rinj, Këshilli, në vijim të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore përfshirë dhe pasurinë e figurën, të kandidatëve për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022, profili gjyqtar, vendosi kualifikimin e 2 (dy) kandidatëve: znj. {...} dhe z. {...}.

Më tej, Këshilli vendosi për kryerjen e verifikimeve të tjera shtesë, referuar kualifikimit/skualifikimit të kandidatit z. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2021-2022.

Gjithashtu, Këshilli vendosi kualifikimin dhe vijimin e procedurës për emërimin në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë, të znj. {...}.